



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 844/ 2 prot.,

Datë 20.04.2023

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “W. Center” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-56894-01-25-2023, me objekt “Blerje materiale pastrimi”, me fond limit 39,999,986 (*tridhjetë e nëntë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e gjashtë*) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 23.03.2023 nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “W. Center” SHPK
Adresa: Rruga “Dritan Hoxha”, Pallati “Teknoprojekt”, Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor:** Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike.
Adresa: Rruga “5 Maji”, Tiranë.

Në datën 19.04.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 844 prot, datë 19.04.2023 e operatorit ekonomik “W. Center” SHPK për procedurën e “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-56894-01-25-2023, me objekt “Blerje materiale pastrimi”, me fond limit 39,999,986 (*tridhjetë e nëntë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e gjashtë*) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 23.03.2023 nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “W. Center” SHPK.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:

b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”.

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik ankimes “W. Center” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. 844 prot., datë 19.04.2023.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyen e skualifikimit si më poshtë vijon:

- **Arsyet e skualifikimit:**

1. Skedat teknike për produktet 16 dhe 26 nuk janë paraqitur në SPE.

2. Skedat teknike të paraqitura për produktet nr.2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 21, 22 nuk kanë të pasqyruara kërkesat teknike të kërkuara në DST.

3. Produktet e ofruara me nr.17, 18, 19, 20 nuk plotësojnë Standartin Teknik të kërkuar SSH EN 13432:2005 të kërkuar në DST për qese plastike të biodegradueshme”.

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 20.04.2023.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova